

Tabela e përmbajtje

A. BILANCI KONTABEL
B. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
C. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE
D. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA.....
E. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyrat Financiare 2020

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione të përgjithshme

“Adriatica Holding” sh.p.k, është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 11.01.2017. Kapitali regjistruar është 100.000 leke dhe zotërohet nga ortakët e shoqërisë Kurtish Kurti në vlerën 50 % dhe Ilija Arnaudovski.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për vitin ushtrimor 2020 janë shërbimet në fushën e ndërtimit.

2. Deklaratë e Pajtueshmërisë me SKK-të

Pasqyrat financiare (individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të), të përmirësuara, dhe me kërkesat e ligjit “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Përmbledhje e Politikave Kontabël të Rëndësishme të Zbatuara

3. Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera, dhe parimit të të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

4. Politikat më të Rëndësishme Kontabël të Zbatuara:

4.1 Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të tregtimit të të ardhurave të shoqërisë dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivitete financuese janë aktivitetet që çojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huasë të shoqërisë.

4.2 Aktivët dhe Detyrimet Financiare

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi financiar ose një detyrim financiar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një

Pasqyrat Financiare 2020

transaksion financiar, matja e aktivitetit financiar ose detyrimit financiar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave financiarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara në pikën 7 dhe 8 të SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesi për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

4.3 Inventarët

Fillimisht, inventari njihet atëherë kur shoqëria e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me tregtimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të mallrave përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njohjes, inventari matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Në rastik konkret kompania nuk ka inventare pasi ska filluar veprimtarinë.

4.4 Shpenzimet e Shtyra dhe të Arkëtueshme nga të Ardhurat e Konstatuara

Shoqëria zbaton politikën e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

4.5 Aktivët Afatgjatë Materiale

Aktivët afatgjatë materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktiviteti kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të hyrë dhe kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe e aplikon këtë model për të gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Pasqyrat Financiare 2020

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor

Shoqëria vlerëson në çdo datë të raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund të jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivit. Nëse nuk ka të shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme të vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përgjatë jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura për groposje), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % të dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur ndërsa për aktivet elektronike norma e përdorur është 25%.

4.6 Aktivet Afatgjata Jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktiviteti nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiv jomaterial bëhet me kosto, ndësa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

4.7 Njohja e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe të produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura; shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren; kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri; është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëliti) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit

Pasqyrat Financiare 2020

efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëliti) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtuar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

4.8 Transaksionet me Monedhat e Huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafërt me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs mesatar i një jave ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetarë me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin.

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë 1 euro=123.7 leke dhe 1 dollar=100.84 leke.

4.9 Tatimi mbi Fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përveç tatimit të zërave që njihen direkt në kapital, i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2020 është 5% .

Pasqyrat Financiare 2020

Informacion Mbështetës për Zërat e Paraqitur në Pasqyrat Financiare, në Rendin në të cilin Paraqitet çdo Pasqyrë dhe Zë Përkates

5 Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke , ne datat 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 jane si me poshte:

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund të ushtrimit. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga B.Shqipërisë.

6. Të Drejta të Arkëtueshme Afatshkurtëra

Ne "Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)" jane pasqyruar faturat e papaguara per shitjet qe shoqeria ka realizuar gjate ushtrimit si dhe tepricat debitore të marrdhenieve me furnitorët.

Ndërsa në "Të Tjera (Debitore të tjerë)" jane pasqyruar kërkesat debitore ndaj tatim taksave dhe te tjera kërkesa, siç paraqitet ne pasqyren e mesiperme.

Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arkëtohen në një periudhë afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

7. Inventari

Vlera kontabël e të gjithë inventareve sipas klasifikimit të bërë nga shoqëria, ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:

Sh.7	Inventarët		
Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019

Pasqyrat Financiare 2020

1	Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		
2	Prodhome në Proces dhe Gjysëmprodukte	-	-
3	Produkte të Gatshme	-	-
4	Mallra	-	-
5	Aktive Biologjike	-	-
6	AAM të Mbajtura për Shitje	-	-
7	Parapagime për Inventar	-	-
	Shuma		

Shoqeria nuk ka gjendje inventari pasi operon vetem ne fushen e sherbimeve softwerike.

8. Shpenzime të Shtyra

Nuk jane evidentuar shpenzime te shtyra ne fund te ushtrimit .

9. Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM-te)

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivet afatgjatë materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

1. Aktivët Afatgjatë Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjatë materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Pasqyrat Financiare 2020

Nr	Gjendjet dhe levizjet	Toka/Terrene	Ndertesa	Mobileri dhe paisje	Paisje Informative	Parapagime për Aktive Materiale dhe	Totali
A	Kosto e AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakësimet	-	-	-	-	-	-
	Kosto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-	-
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	-	-	-
	Amortizimi ushtrimit	-	-	-	-	-	-
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-	-
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-	-
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakësimet	-	-	-	-	-	-
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	-	-	-
E	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-	-

AAM-të, që plotësojnë kriteret për njohje si aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar, janë matur me kosto.

Në vlerësimin e mëposhëm shoqëria zbaton si politikë të saj kontabël modelin e koston dhe në pasqyrën e pozicionit financiar AAM-të janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mesipërme janë të perputhura me të dhënat e inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2020

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve është metoda mbi vlerën e mbetur, e njëjtë me atë që përdoret për qellime fiskale.

10. Detyrime Afatshkurta

Detyrimet afatshkurta në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël paraqiten:

Sh.10	Detyrime Afatshkurta		
Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2020
1	Titujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	0	0
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	0	0
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje		-
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.	0	0

Pasqyrat Financiare 2020

	Paga dhe shpërblime		
	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	0	0
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore	0	0
	Shteti-Tatim mbi fitimin	-	0
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	-	0
	Tatim mbi të ardhurat personale		
	Tatimi ne burim	0	0
10	Të Tjera të Pagueshme	-	0
	Shuma	0	0

Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave e shërbimeve,te cilat jane te pa likujduara ne fund te ushtrimit. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.“Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.” paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj personelit dhe detyrimin e muajit dhjetor 2020 .“Të Pagueshme për Detyrime Tatimore “ perbehet nga tatimi mbi fitimin, tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi ne burim.

11. Detyrimet Afatgjata

Nuk jane evidentuar detyrime afatgjata ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel.

12. Kapitali dhe Rezervat

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, është 100 000 leke ne percaktuar ne statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara ne QKB.

13. Të Ardhurat nga Aktiviteti i Shfrytëzimit dhe të Tjera

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

Pasqyrat Financiare 2020

Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit:	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
Shitje e produkteve të gatëshme dhe nënprodukteve	-	-
Shitja e punimeve dhe shërbimeve	-	-
Shitja e mallrave	-	-
Të ardhura nga shitje të tjera(qera,komisione,etj)	-	-
Totali i të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit	-	-
Puna e Kryer nga Nj.E dhe e kapitalizuar	-	-
Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit	-	-
Të ardhura nga Shitja e Aktiveve Afategjate	-	-
Të ardhura të tjera(grantet,te tjera,.....)	-	-
Ndryshimi në Inventarin e Produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	-	-
Shuma	-	-

Të ardhurat nga shitja e mallrave janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, të zhveshura nga TVSH-ja.

• Shpenzimet e veprimtarisë kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë regjistruar me shumën e paguar ose të pagueshme. Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime të tjera që lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit. Sipas natyrës së tyre shpenzimet e ushtrimit 2020 janë treguar në pasqyrën përkatëse.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme		
Shpenzime Personeli		
Paga dhe Shpërblime	-	-
Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	-	-
Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi	-	-
Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi	-	-
Totali i shpenzimeve	-	-

▪ Shpenzimet të tjera

Nuk janë evidentuar shpenzime në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel.

Pasqyrat Financiare 2020

▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Të Ardhura nga Aktiviteti Pjesëmarres në Njesi të Tjera Ekon.		
Të Ardhura Nga Investimet dhe Huatë e Tjera		
Interesa të Arketueshem dhe të Ardhura të Tjera të Ngjashme	-	-
Shpenzime Interesi dhe Shpenzime të Ngjashme	-	-
Shpenzimet e Tjera Financiare	-	-
Shuma	-	-

▪ Shpenzime personeli

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

Shpenzime Personeli	2020	2019
Paga dhe Shpërblime	-	-
Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	-	-
Të tjera	-	-
Shuma	-	-

-Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2020 dhe 2019 jane si vijon:

Pasqyrat Financiare 2020

Sh.18 Shpenzime për Tatimin mbi Fitimin			
Nr.	Emertimi	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
I	Fitimi/(Humbja) Para Tatimit	-	-
1	Të ardhura të njohura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-)		
2	Dividentët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit(nga investimet e kon	-	-
	Të tjera(rimarrje provizionesh,gjobash etj)(-)	-	-
	Shpenzime të panjohura tatimore(+)	-	-
3	Shpenzime pritje e dhurime tej kufirit tatimor(+)	-	-
	Shpenzime të panjohura nga investime (+)	-	-
	Amortizim mbi normat fiskale(+)	-	-
	Provizione për rezikë e shpenzime(+)	-	-
	Të tjera	-	-
	Diferenca pozitive- Shpenzimet tatimore të lejuara minus njohjet	-	-
4	Amortizimi i përshpejtuar tatimor(-)	-	-
	I e tjera(-)	-	-
	Zbritja e humbjes tatimore(-)	-	-
5			
6	Fitimi i Tatueshëm-Humbja Fiskale(1+2+3+4+5)	-	-
	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin(2019-5%)	-	-
	Shpenzim(të ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë(+/-)	-	-
II			
	Shpenzime(të ardhura) për Tatimin mbi Fitimin(I+II)		

Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin janë respektuar kërkesat e legjislacionit fiskal. Nuk janë identifikuar aktive ,detyrimeve dhe zërave të zjerë që priten të ndikojnë në fitimin e tatueshëm nëse ato do të realizoheshin ose shlyheshin me vlerat e tyre kontabël aktuale, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme. Për rrjedhim nuk është njohur asnjë tatim fitimi i shtyrë.

Inventari

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër perputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2020. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda "mesatares së ponderuar". Gjendje Inventari me 31/12/2020 nuk ka pasí ofron vetëm shitje të shërbimeve softwerike.

Shënime të tjera Shpjeguese

- Ngjarjet pas Dates së Bilancit dhe Vazhdimësia e Shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

- Shpjegime mbi Palët e Lidhura

Me marrjen në konsideratë të çdo transaksioni dhe marrëdhënie të mundshme, jo thjesht formen ligjore të tyre në 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

Pasqyrat Financiare 2020

- Shifrat Krahase

Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2, (të përmirësuar) dhe gjithashtu çeljet e vitit paraardhës.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i “Adriatica Holding” sh.p.k dhe janë firmosur nga:

Administratori

Kurtish Kurti
KURTISH KURTI


